



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 69

Prishtinë, më 11.5.2010, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Naser Rugova, Heset Cakolli, Berat Luzha, Elheme Hetemi, Selvie Halimi, Myrvete Pantina, Ali Lajçi, Zef Morina.

Mungoi : Branislav Grbić, Naim Maloku, Zulfi Merxha.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : zyrtarët nga MBPZHR-Shefki Zeqiri, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku.

Mbledhjen e kryesoi **Naser Rugova**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 20.4.2010,
3. projektligji,
4. Të ndryshme.

1. Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e **rendit të ditës**, për të cilat nuk kishte vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 20.4.2010

Kryetari konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

3. Projektligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për ujitjen e tokave bujqësore

Kryetari **Naser Rugova** falënderoi grupin punues i cili me angazhimin e tij ka kontribuar që komisioni sot të shqyrtoi amendamentet e propozuara si vijon :

Amendamenti 1

Në tërë tekstin e ligjit në fuqi shkurtesa **AKM** zëvendësohet me shkurtesën **AKP**.

Amendamenti 2

Preambula i ligjit në fuqi të riformulohet si vijon :

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me qëllim të rregullimit të ujitjes së tokave bujqësore në Kosovë,

Amendamenti 3

Neni 2 – Në reshtin e dytë pas fjalisë së mbyllur me thonjëza shtohet “**si dhe fshihet fjalia “afarizmin e shoqatave” në fund të reshtit të nenit 2 dhe vazhdon “ndërsa.....**

Amendamenti 4

Neni 5 – Në reshtin e 7 numri **5.1.1** të zëvendësohet me shkronjën **f)**, ndërsa që më poshtë numri **5.1.2** me shkronjën **g)**.

Reshti i fundit i këtij neni riformulohet :

Paragrafi 5.2 pika d) riformulohet si vijon : d) në përbërjen e bordeve mbikëqyrëse të ndërmarrjeve të ujitjes duhet të jetë një anëtarë nga ministria e bujqësisë.

Paragrafet 5.3 dhe 5.4 të ligjit në fuqi fshihen.

Amendamenti 5

Neni 6 – Numri 6 në reshtin e parë të zëvendësohet me **5A**, ndërsa në vijim në reshtin e 3 pas lidhëses “për” shtohet “**dhënien e**”, fjala “**udhëzime**” bëhet “**udhëzimeve**”.

Selvie Halimi nuk u pajtua që numri 6 të zëvendësohet me 5A por nenet e ligjit ekzistues të rirreshtohen.

Kryesuesi i grupit punues **Zef Morina** dhe disa tjerë anëtarë, përkrahur nga stafi (Drejtori Daut Beqiri), u pajtuan për këtë zëvendësim ngase ligjit ekzistues nuk bën ti ndërrohen numrat e neneve. Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

Teknika juridike e hartimit të këtij ligjit (në këtë rast të ndryshimit e plotësimit) të vendoset nga ana e administratës së Kuvendit-divizionit përkatës, në bashkëpunim me komisionin.

Amendamenti 6

Neni 7 – riformulohet në fillim : “**Neni 6 i shtohet paragrafi 6.5 me tekstin si vijon:**”.

(lidhur me tekstin e nenit 7, zyrtarët e ministrisë së bujqësisë të konsultohen me MEF, MMPH dhe ZRRUM për të zëvendësuar tekstin apo jo lidhur me Bordin, deri në mbledhjen e radhës).

Amendamenti 7

Neni 8 - Neni 8, pasusi parë riformulohet si vijon :

“Titulli i Kapitulli IV të ligjit në fuqi tek Neni 7 riformulohet : “Bartja e përgjegjësiave për mirëmbajtjen dhe operimin e sistemit të ujitjes”.

Pasusi i dytë (lidhur me paragrafin 7.1) **fshihet.**

Amendamenti 8

Neni 10 - reshti 4, numri **51** bëhet **50**.

Amendamenti 9

Neni 24, riformulohet si vijon :

“Te Neni 30 në reshtin e 2 pas “shoqatave” shtohet “**dhe shfrytëzuesve tjerë**”, ndërsa në vazhdim të reshtit fjala “përcaktuara” bëhet “**propozuara**”. Në fund të tekstit të këtij neni shtohet :”**Bordi mbikëqyrës aprovon tarifat për furnizim për ujitje**”.

EDHE KY NEN MBETET I DISKUTUESHËM DERI NË MBLEDHJEN E RADHËS, SQARIMET DO TË BËHEN NGA ZYRTARËT E MBPZHR.

Neni 28 Mbetet ashtu si është.

Në mbledhjen e radhës do të miratohen amendamenti 9 dhe amendamenti 6.

4. Të ndryshme

Naser Rugova lidhur me disa çështje aktuale në komision sugjeroi si vijon :

- pasi që nuk prezantoi përfaqësuesja e komisionit evropian Iva Stamenova, propozoi që në mbledhjen e radhës e njëjta të sjellë sqarime precize për vizitën që duhet ta bëjë komisioni në Bruksel, për mos me mbet pezull puna e komisionit,
- raportin vjetor nga ZRRUM komisioni do të shqyrtoi më 18 maj duke ftuar drejtorin e ZRRUM për miratim nga komisioni,
- delegacioni i komisionit 4 anëtarësh (Naser Rugova, Berat Luzha, Myrvete Pantina dhe Branislav Grbiç) udhëton në Estoni më 16 maj herët në mëngjes për çka duhet të kujdeset divizioni i protokollit të Kuvendit.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 14,15.

Kryetari i Komisionit,
Naser Rugova